



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1075/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Hasan Shala, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Islam Vrenëzit kandidat për asamblenë komunale në Malishevë nga Iniciativa Qytetare për Malishevë (IQM), paraqitur kundër Komisionerëve të 3047A/01R, për shkak të mungesës së votave, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET si e bazuar ankesa e Islam Vrenëzit nga Iniciativa Qytetare për Malishevë (IQM).

URDHËROHET KQZ që të rinumëroj fletëvotimet në Vendvotimet 3047A/01R, dhe ky numërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të 3 Nëntorit 2013.

A R S Y E T I M

PZAP-i me datën 03.12.2013 ka pranuar një ankesë nga Islam Vrenëzit kandidat për asamblen komunale në Malishevë nga Iniciativa Qytetare për Malishevën (IQM), në të cilën pretendon se përshkak të mos numërimit të pikës 3047A/01 pasi që në atë pikë nuk është plotësuar formulari për asamblenë në të cilën pikë parashtuesi i ankesës pretendon se i posedon 78 vota në bazë të të dhënave nga komisionarët e tyre të cilët kanë qenë në atë pikë përshkak të mos numërimit të votave ka mbetur jashtë listës së asamblistëve.

PZAP-i pas shqyrtimit dhe analizimit gjeti se:

- **ankesa është e bazuar**

PZAP-i nga shkresat e lëndës të ofruara nga pala ankuese si dhe nga hetimi i bërë në QNR ka vërejtur se ka pasur parregullsi në këtë vendvotimi pasi që gjatë hetimit të bërë në QNR ka vërtetuar se FRK-ja e vendvotimit 3047A/01R fare nuk është plotësuar. PZAP-i në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në këto vendvotimeve. Andaj PZAP nga këto arsye e më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura si dhe në mbështetje të 117.4 lidhur me nenin 118.1 dhe 119.5 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa
A nr. 1075/2013 më datën 06.12.2013.

Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala



Këshillë Juridik:

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankese në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njezetekater (24) orëve nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i